Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 04/193
Datë 23.06.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2020 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet "Academy & Studio Jehona" Sh.p.k me adresë, Rr " Rexhep Bislimi, nr 13 Ferizaj për periudhën dy vjeçare 08.06.2020 deri 08.06.2022 me kualifikimet:

   1.1. **Parukeri, Niveli III sipas KKK me 48 kredi të AAP**

   1.2. **Grim, Niveli III sipas KKK me 160 kredi të AAP**

2. Numri i kandidatëve që lejohet për grup duke u bazuar në hapësirën fizike, në pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik është:
   - Parukeri, 12 kandidatë
   - Grim, 12 kandidatë

3. Nuk akreditohet dhe validohet "Academy & Studio Jehona" Sh.p.k me adresë, Rr " Rexhep Bislimi, nr 13 Ferizaj, për kualifikimin:

   3.1. **Manikyr, Niveli III sipas KKK me 20 kredi të AAP**

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Rivalidimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

4. Vendimi u dërgohet:

- Academy & Studio Jehona Sh.p.k
- Arkivit të AKK

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema